



## KALENDARËT PELLAZG - KALENDARËT E PARË EUROPIANË

nga prof. Sazan GURI

### DETYRIMI PËR KALENDAR I NJERIUT TË ASOBOTE

Dihet që njeriut prej kohësh i është dashur të orientohet me ditët e caktuara të vitit apo të motmoteve apo me fillimin e hënzës së plotë e atë të mangët deri në atë ndikimeve të planetëve. Ndaj dhe më parë se të ndërtonte marrëveshjet njerëzore me motet, kohën, muajtë, javën, ditën, etj, ai studioi për mijëvjeçarë sistemin tonë diellor dhe jo vetëm, për ata që besojnë në evoluimin shkencor, por, ndoshta dhe i erdhi për pak vite, i gatshëm nga njerëz jo tokësorë për ata që besojnë në ufo-t. Rezultantia ishte, se njeriu qysh në vitet 6000-5000 para krishtit kishte një sistem matës të kohës tepër të sakt, e quajtur ndryshe kalendar, (me anë të shqipes shpjegohet edhe etimologjia e saj, si kohë e lindur), ku viti ndahej në 12 muaj, muaji në javë me 7 ditë 24 orëshe, ku gjithçka përcaktohej perfektazi në kohë e në hapësirë dhe në emertime, sikundër pothuaj ashtu si thirren edhe sot. Kësisoj, u përcaktuan planetët dhe jo pak 11 prej tyre, dhe të 12-tin e kanë lënë të nënkuptohej, (Ylli Sirius), ku shkenca po rreket aq shumë sot.

Pse 12 planetë shëtitës rreth diellit ose antarë të sistemit tonë diellor, pse 12 muaj, pse 12 orë, pse 12 shenja të zodiakut, pse 12 antarë të familjes magjike të Krishtit, pse 12 dishepuj të Muhametit, pse dyzinë kompletësh, pse ky numër 12 magjik, dhe 13-ta numër ters, kjo kërkon shpjegimin e saj sa mistik, sa shkencor, sa fetar, por mbi të gjitha kërkon një nge tjetër. Sikundër dhe shtata që përbën një numër tjetër magjik, si shtatë mrekulli, çerek cikli hënor, 7 ditë jave, ku njeriu i at'hershëm iu gjeti edhe emrat përkatës për nder të planetëve, që ndikonin në jetën e përditëshme, si dhe në shëndetin mjedisor dhe atë njerëzor. Si për çudi, ky dokumentim i parë, neve sot na vjen sipas dy mënyrave. Ose nga ndërtimi i shkallëve dhe hieroglifëve nëpër piramida ose sipas shkrimeve të tipit kuiniform nëpër gurët e lënë si testament nga S(h)umerët e Babilonisë ose sipas gjuhës së kënduar e të përcjellë në mijëvjeçare të Shqipes.

Dihet se ditët e javës kanë pasë filluar me atë të më të madhit të të mëdhenjëve, pra ati i tyre, ose *Shën ati –Saturni-e shtuna*, për të kaluar tek mishërimi i planetit qendër, *i Diellit – e diela*, (që lidhet me shqipen dije, dritë, djalë, ditë, del), kollaj fare i lihet vendi planetit satelit që ndikon më shumë në jetën në tokë, kuptohet *Hana-e han*, e hëna (që lidhet me shqipen si diçka që hahet), për të vajtur te planeti pas saj Mars-e marta, (që lidhet me shqipen si një planet me shtrëngata, si i marrë), për të kaluar te planeti tjetër Merkuri–e merkurë. Deri këtu, kalendarët pellazg, ilir apo shqiptar ranë dakord ose dhanë e morrën me kalendarët e shoqërive të civilizuar, duke mbajtur emra të përbashkët për pesë ditë e sipërmendura të javës. Ndërkohë, si mësuesi me nxënësin spordhjak që pas disa mësimëve i duket vetja i ditur, mbajti për vete, me emrat e parahistorisë njerëzore dy ditë të javës, si ditën e zjarrit, e anjit-e entur, e enjte, dhe ditën e premtë, venera për vendra, (e bukur si venera, shën e vertë) më vonë e premta. Pra, është i vetmi popull, që i thërret ata, një pas një, si 6500 vjet më parë, kur kombet e tjera përreth e anembanë i thërrasin ditët e javës sipas numrave rreshtor.



Por, jo vetëm kaq. Edhe muajt, ky popull, sidomos ai gegë, i ka pasë thirë me emër, sikundër edhe sot, si p.sh. Mars-m(b)ar, me të cilin fillonte viti i pellazgëve, ilirëve apo shqiptarëve për të uruar mbarrësi (të qoftë udha e m(b)ar-mar); Prill - që viti të prij-ë me ushure, sepse hapet dita; Maj-sepse është muaj i madh me ditë, me dritë, Qershor-sepse lidhet me vjeljen e qershisë ose kur bie shi, Korrik - sepse korr drithra, Gusht-zagushi, gunë, ngushtohet dita-ngusht, Shtator, tetor- vjeshta e parë, e dytë ose vjelja e parë, e dytë, Nëntori-thiresh brumeri, për shkak të brymës, brumës që është fjalë tipike shqipe, Dhjetori- quhesh dimën-ditë të mënuara, ditë të zemëruara, të mërdhira, dhe kur u thir sipas kalendarit gregorian dhjetor, fjala pellazge dimër gjene nuk u hoq, por ia la vendit stinës së dimrit. Janari thiresh kalnuer nga të qenurit kalkan dhe Shkurti thiresh farori, sepse hidhej fara e të lashtave, vonë kur perandori August i mori një ditë për gushtin, u quajt prap me emertim shqip ngaqë ngeli i shkurtër.

Pra, kjo na bën të mendojmë, se ky popull ka pasë qenë i orientuar me kalendar, qysh në kohët e para lashtësisë. Ndërkohë, që popujt e tjerë, si shumerët, babionasit, asirët, egjyptianët, më vonë grekët, e më vonë latinët, kujtonin se secili nga ata, mbasi e "vidhte" kalendarin nga gojëdhënat dhe nga ato shkrime të mbijetuara e bënë si të tyre. P.sh., Sumerët e masnin me daljen e mbretit të parë në skenën e historisë së tyre, (me *nfilimet, kujdes fillistarët, të parët*) Egjyptianet e masnin me kohën e ndërtimeve të mumjeve për personifikimin e përjetshëm të Faraonëve (kujdes - fara jonë), Grekët e masnin me lojrat e para olimpike të tyre të kryera në Spartë në 780 para Krishtit, Romakët i masnin datat me pushtimet e Cezarit, por të gjithë së bashku, në kalkulimet e tyre kishin në mendje ato të Pellazgëve, që janë ruajtur në pllakat sumere, etruske, mot a mo, në malet Pindus, në zemrën e maleve të labërisë, çamërisë dhe në bjeshkët e veriut-Gegënisë (popuj mbetës të pellazgëve të rrudhur apo të shtrydhur).

*Jo rastësisht është ky popull parak dhe pasardhësit e tij direkt (shqiptarët, por në veçanti gegët) që ende përdorin kalendarët e parë të njerëzimit me emra tipikisht shqip, si vjelja e parë për shtatorin, vjelja e dytë për tetorin, farori për shkurtin që hidhej fara, kallnuer për janarin meqenëse ishte koha kallkan, dimënpër dhjetorin, meqenëse ditët ishin të mnuara, të zemëruara, etj.*

## **KALENDARËT E PARË ZYRTARË**

Gjithësesi, kalendar i parë zyrtar mbahet, ai, i kohës së Jul Cezarit, ku një mesap kalabrez, (fis prej Ilirësh, prap racë shqiptare), avokat për nga zanati, Lilius e thërrisnin, i propozon Perandorit kalendarin e vet, me bazë egjyptiane, më sakt me bazë Shumeriane, i ndërtuar si kalendar i pastër diellor, pothuajse ai që kemi sot, por me gabime (një ditë në 128 vjet), që u korrigjuan me dekret të Papës Gregoriani XIII, më 1582. Vetë perandori Cezar hoqi emërtimin e muajit korrik të mbritur deri në kohë të vet prej perandorëve etruskë (që sunduan Romën nga vitet 770 deri në ato 350 para krishtit), dhe e quajti Jul, ndërsa pas tij qe Perandori tjetër, i nipi, Oktavian Augusti që pasoi me ambicien e të ungjit, duke hequr emrin e gushtit dhe e quajti agosto, madje guxoi më tepër se i pari, duke marrë dhe një ditë nga shkurti dhe e vendosi tek ky muaj, ndaj dhe kemi qysh at'herë korrikun e gushtin me 31 ditë. Ky kalendar ndoqi shekujt e mëpastajmë, ku kombet, një nga një, fillimisht, ata katolikë pastaj ata protestantë, pasuan dakordësinë e tyre me këtë tip, derisa edhe



ortodoksët grekë e rusë në fillim të shekullit 20 arritën dhe e morrën për kohëtregues. Prandaj, dhe revolucionit të tetorit të Leninit, i ndodhur më 17 tetor sipas kalendarit rus, sot quhet si i 7 tetorit, sepse kalendari Gregorian hoqi 10 ditë nga ai i Cezarit për të përputhur, saktësisht kohën diellore me atë kalendarike.

Veç kalendarit diellor ekzistojnë edhe kalendarë, tipikisht të pastër hënorë, me të cilët përputhen llogaritjet e kalendarit musliman për të kryer ritet e festave të Ramazanit, e Kurbanit të madh apo të Kurbanit të vogël. Pastaj, kemi dhe kalendar diellor hënor, si ai Shumerian, dhe hënor diellor si ai Kinez e Izraelit, dhe/ose kalendar, si ai i fiseve Maya, që përshtat ciklet e diellit me ato të hënës. Por, klasifikimet e kalendarëve nuk kanë të sosur. P.sh., një tip është ai që bazohet në rregulla (si ai i Mayave apo ai Gregorian dhe ai Cezarian). Ka kalendarë që bazohen në observime astronomike, si ai Musliman, që llogarit saktë momentin e sekondave të para të çfaqjes së drapërit të Hënës, që iu duhet për festimet, siç shpjeguar më lart. Por, ka edhe nga ata kalendarë që bazohen në llogaritje astronomike, si ai Kinez dhe Izraelit. Gjithësesi, kalendari bazë mbetet, ai i hartuar nga pellazgët nëpër pllakë Shumere, por i ruajtur nga shqiptarët, që bazohet tipikisht në fillimin e një viti të ri, sipas ciklit diellor, që përmbushet pikërisht më 25 dhjetor dhe konvencionalisht apo me marrëveshje dëfthehet me 1 janar.

Pse më 25 dhjetor? Dihet se data 22 dhjetor përfaqëson solsticin dimëror, ku nata pushon së rrituri dhe/ose dita pushon së ngrënuri. Dita e parë dhe e dytë pas kësaj, pra, 23 dhe 24 dhjetori përfaqësojnë pushimin (stillstand) ose ekuilibrin ose marrjen e forcave të ditës ose gjenerimin ose lindjen e ditës, që realisht fillon të marrë e të mund t'i maten sekondat e para pikërisht më datë 25 dhjetor. Pra, këto sekonda përbëjnë realisht sekondat e para të një dite të re, të një jave të re, të një muaji të ri apo të një viti të ri, por jo vetëm ditë, por edhe dritë më shumë, por edhe fotosintezë më shumë, por edhe oksigjen më shumë. Pikërisht, në këtë moment, uji fillon të pjellë ujë, ose të gjenerojë vetveten, që në kuadrin e dy javëve apo gjysëm cikli hënor, duke i hedhur dhe kryqin më 6 janar me nitratin argjendi si katalizator, ai arrin të shpërndahet në gjithë ujërat e botës dhe kushdo mund të marrë nga ky ujë në çdo pikë të globit dhe të të mos i prishet, prandaj dhe ai në këtë ditë quhet ujë i bekuar. Po në këtë moment, fillon zgjimi, avash avash i kafshëve, shkundja nga letargjia, përgatitja për një jete të re e botës së gjallë, çelja e sytheve të shumë bimëve, si mimozat, etj. Pra, jeta, gjithandej lind, por mbi të gjitha njeriu.

Dhe pikërisht këto ditë, duke filluar qysh nga data 17 dhjetor deri më 24 dhjetor festoheshin saturnalet, *ditët e at-it të planetëve*, me hare e gëzim të madh, me të pira e të ngrëna, me dhurata për një vit të mirë e të ri për të hedhur dertet pas, me dindekolinde nëpër portat ku plakat delnin dhe jepnin karamelle e të shkoqura, dhe më 25, njerëzia i kthehesh punës nga e para. Këto festa, që ndryshe quheshin pagane, festa të mirëfillta natyrore, po aq shkencore, sa as sumerët, e as basbilonasit e as asirët, as egjyptianët, e as grekët më vonë, e as romakët më vonë akoma, nuk mundën t'i përçudnonin, përkundrazi, i zhvillonin po aq, e mos më tepër, vetëm me ndryshimin, se gjoja i kishin shpikur vetë për nder të perëndeshës së bujqësisë me emrat e vet, por që vetëm ky komb i ruajti si në fillimet apo origjinalin e vet. Vonë vonë, më 385 të erës sonë, ky rit u zyrtarizua për të krishterët, se në këtë datë paskesh lindur, edhe i madhi Krisht, që në fakt, sipas Biblës ishte

lindur pa zbritur barinj nga mali që i bie diku nga ditët e shpirtit ose fundi i Tetorit, por me që festa pagane (lindja e vitit sipas kalendarit pellazg) ishte më e fortë në memorien e njerëzve, e çuan lindjen e Krishtit më 25 dhjetor.

Pra, festat, datat, muajt, ritet, javët e kalendarët ishin shpikur njëherë, ku një popull si Shumerët i ruajtën në gur dhe një popull si pellazgët, më vonë shqiptarët i ruajtën në lahutë. Prandaj, dhe ne shqiptarët nuk kemi asnjë lidhje me festën e vitit të ri në 01 janar, përveç asaj kohe të diktaturës ose kur të tjerët na e kanë detyruar, dhe ne si popull i vogël për të ruajtur fjalën e parë të dhënë Zotit ose natyrës për ata që nuk besojnë, gjoja i kemi respektuar, por jo besuar. Kësisoj, festa për t'u festuar ndër ne shqiptarët, sot, është ajo e të parëve tanë-25 dhjetori, që as përhapja e kulturës greke, e as pushtimi romak, e as sundimi bizantin, e as dyndja turke, e as ateizmi i kuq, nuk mundën të prishnin këtë datë, si në fillimet e veta.

## KUPTIMI I MUAJVE

**Mars** – si muaj ku at'herë fillonte viti, që rrjedh nga fjala - mâr, që do të thotë muaj ku gjithçka në natyrë fillon të gjallërohet, duke e uruar atë si mbar, pra për të marshuar në mbarësi, drejt.

**Prilli**, sepse hapet dita, vjen nga fjala me pri, me dal përpara.

**Maj**, sepse është muaj me ditë, me dritë, i majmur, i shëndoshë, i trashur, pra shkurt muaj i madh. Mos harro se nga fjala njërrokshe pellazgo-ilire-thrako-shqiptare rrjedh fjala majore, mayer, major, mega, maximo, miqiarëm (madhëri turqisht). Në Shkodër p.sh., muaji maj quhet muaji i Zojës. Në këtë muaj duhet të heqësh dorë nga një ves.

**Qershor**, më sakt Kershori siç është thirur historikisht nga pellazgët, sepse lidhet me vjeljen e qershisë, që vjen nga kersh i apo muaji i qershive ose me fjalët kur-shi, pra kur bie shi, siç ndodh shpesh në qershor, muaj i shiut të dobishëm që bën të piqen qershitë.

**Korrik**, sepse korr drithra, muaj i të korrave. Dhe Korrinthi në Greqi sot, ndaj është thirur po kështu, sepse kanë qenë fusha të mëdha me grurë asokohe dhe vendi i nënshtrohej një procesi të madh të të korrurave.

**Gushti**-zagushi, gunë, ngushtohet dita-ngusht, por edhe nga fjala dushk, sepse është muaji ku mblidhej dushku për dimërimin e bagëtive. Ky rit vazhdon dhe sot e kësaj dite të fshatarët tanë, ku muaji gusht është muaji i zaeresë apo i ushqimit për bagëtinë.

**Shtatori**, më sakt britmi i parë, vonë-vonë është thirur ndryshe vjelja e parë, prej së cilës erdhi fjala vjeshta e parë, pra muaji i britmës, i zhurmës së ernave, të stuhive, të bubullimave, të rrufeve. Ju kujtoj se bëhet fjalkë për 10-12000 vjet përpara, ku klima po delte nga cikli akullnajor i ndodhur 18,000 vjet më parë dhe njeriu i mesdheut apo i trevës pellazgjike po ballafaqohej me tiparet e stinëve të një cikli tjetër klimatik.

**Tetori**, britmi i dytë, vonë vonë është thirur ndryshe vjelja e dytë, prej së cilës erdhi fjala vjeshta e dytë, pra muaji i dytë i britmës, i zhurmës së ernave, të stuhive, të bubullimave, të rrufeve. Këto dy muaj janë ato ku natyra shpërthen me elementët e saj, sepse janë këto dy britma që sjellin brymën muajin më pas.

**Nëntori**, i thirur historikisht nga pellazgët, më vonë ilirët dhe deri para disa dekadash edhe nga shqiptarët, si brymori, muaj i brymës dhe i ngricave të bardha. Mos u çudisni me procesin ngric, sepse at'here fillonin e ndodhnin qysh në këtë muaj. Mos i masni të dashur lexues me kutin e sotëm të klimës, aq më tepër që jemi në një cikël diametralisht të kundërt, atë të ngrohjes globale.

**Dhjetori** ose dimnori, për shkak se ishte muaj i vrejtur i mërzitur apo i mënuar, të shkurtuara, të pamjaftueshme, i inatosur i xhindosur, pra ditë të mnuara – dimën. Vonë vonë me këtë term u përkufizua stina dimën ose në gjuhët e botës – vinter –vrjntun.

**Kallnori**, Janari, muaj i borës dhe i ngricës, fjalë që vjen nga kallni, ngricë që ka lidhje me akull. Edhe sot në malësi të madhe e në veri gjithkund përdoret kallnueri, prej së cilës bota romake e mori prej etruskeve dhe e përhapu me pushtimet e saj dhe e quajti January. Vetë fjala akull vjen nga psherëtima ah prej ujit, sepse fjalët, siç e kemi shpjeguar kudo në këtë libër kanë pasë lindur ke primati pellazg nga veprimi dhe gjurma që lë procesi në lidhje me njeriun. Pra, ah uj – akull, që është bërë kall, vonë vonë kallkan turqisht, por latinët me akulin pellazg formatuan fjalën acqua për ujë, anglezët fjalën cool për ftohtë, etj.

**Farori**, ose frori i quajtur historikisht nga pellazgët bujk apo fermer, sepse ishte muaji që hidhej fara në arrë, që bënte vaki mos ta realizoje këtë muaj ngeleshe pa bereqet. Mos harroni se nga fjala njërrökshe pellazge „far“ vjen apo rrjedh fjala ndërkombëtare farm ose ferm, pra çështë ferma? Tokë ku hidhet fara, që fjala far nuk ka kuptim në gjuhët e botës. Pra, ja u dhamë far-ë dhe morrëm prej tyre ndoshta konceptin farm. Por kjo do të diskutohet në pjesën e fjalorit pellazgisht-greqisht-latinisht... etj. Nga frori ose farori erdhi fabruary për gjuhët e përpunuara latine apo neolatine. Vonë, vonë kur Jul Cezari i mori një ditë shkurtit ai u quajti **Shkurt**, sepse u bë i shkurër, si ditë në muaj, por edhe sepse shkurton urat e zjarrit, sipas shprehjes shkurti shkurton urat, për shkak të të ftohtit të madh, duke hedhur më shumë ura në zjarr dhe duke u djegur më shpejt ato në vatër. Por, edhe frori bishtnori, sepse quhej muaj i pabesë, muaj që luan bishtin, mashtrues. Dimnori e kallnori e ban frorin bishnorin. Shihni me çkuptime klasifikohen muajt deri në detajet natyrore të vetat.

Gjeni shprehje kaq epike apo lirike për muajtë në gjuhët e tjera. Pra, edhe shkurti, sikundër çdo emër muaji, ktheje nga të duash, fjala bazë me adresë kuptimore sipas veprimit lidhet me rrënjë bazike shqipe. Madje, gjeniu pellazg ka formuar edhe shprehje të tjera të urta për muajt e parë të vitit, njëherësh për vetë vitin, si mars – prill- maj ose e thënë ndryshe prej tyre m(b)ar - prin – majm, në kuptimi që mbarësia na prin te bollëku, që në të kundërtën do të thotë që nëse marsi nuk prin mbarë, maji nuk do të jetë i majm, që i bie më pas dhe qershori, edhe të korrurat edhe zairet e gushtit, edhe kështu më pas që vjen britmi i parë (shtatori), britmi i dytë (tetori), brymeri Nëntori), dimni (dhjetori), kallnueri (janari), pastaj i bie sa të hedhësh farën (shkurt), e kismet viti tjetër. Ndërkohë, grekët ditët e javës i emërtojnë kështu: e diela përfaqëson Zotin, e hëna është dyshi, e



marta, është treshi, e mërkura, është katra, e enjta, është e pesta, e premtja, është dita e Shën Mërisë, të shtunën e kanë marrë nga hebrejët.

Në botimin “ Studime shqiptare”. Në pjesën e dytë me titull “Përshkrimi zakoneve”, Hann shkruan edhe për kalendarin e Rrëzes së Tepelenës, që për çdo rrëzjot, sot përben një kuriozitet<sup>1</sup>:

**Shtatori** – është dita e parë e fillimit të vitit të ri, prandaj çdo ngjarje e kësaj ditë paragjykohej, si paralajmërim për të gjithë vitin.

**Tetori** – në javën e parë nuk shkohej në arë, nuk mbillej në gjithë muajin, dhe gruri duhet të mbillet para tetorit, sepse pas tij nuk do të mbinte.

**Nëntori**- prej datës 15 deri në 6 janar janë kërrshëndellat, ndërsa në 6 janar është dita e ujit të bekuar.

**Dhjetori** – në datën 24 është dita e krishtlindjeve dhe e kolendrave. E para e kolendrave është e qeve dhe varej në murin e dhomës për t'i prurë mbarësi shtëpisë. Kur fillonte lëvrimi i arave, fshatari e thyen atë tek balli i qeve dhe ja u jep ta hanë.

**Janari**- është darka e Shën Vasilit, ku zjarri rri ndezur për gjithë natën, e ruan një grua me barrë, me shpresë për të pasur një lindje të lehtë. Ditën e motit të ri, në mëngjes venë re kush hyn i pari në shtëpi.

**Shkurti** – dita e parë e Shën Trifonit, ndërsa në 2 shkurt është dita e Shën Mërisë, ku në kusi do ziejnë gjithëfarë kokrrash fasule, qiqra, misër, grurë, elb, etj., dhe kjo gjellë quhet “karkashina”.

**Marsi** – ditën e parë hidhnin në zjarr gjethe rrushkulli (shkulja e luleshtrydhes). Nëse kjo bënte zhurmë ishte shënjë e mirë për personin që u përmënd, ndryshe ishte e ligë. Në këtë mbrëmje ngjeshin dhe një plis dhëu me bar qumështor pas portës, që lopët të japin më shumë qumësht. Në 23 mars, ditën e Shën Gjergjit, dilet shëtitje dhe në kokë vihet një kurorë me lule.

**Prilli** – në ditën e parë thuhet fjalët: *Doli marsi, hyri prilli, Me ferman këndon bilbili*.

**Maj** – burra dhe gra ngrihen sa më herët në mëngjes, hanë shpejtë një kokërr hudhër pa dëgjuar gomarin kur pëllet, me barkun bosh. Sepse kush e dëgjon për herë të parë nuk i shkon puna mbarë. Në këtë ditë të parë, i madh dhe i vogël mbledhin lule dhe zbukurojnë dyert.

**Qershori**-nuk shkojnë në vresht që mos dëmtohet nga insektet, ndërsa për t'i luftuar në tri të diela hedhin hi. Në darkën e Shën Gjjonit, ndezin zjarr e mbi të kalojnë gjithë moshat.

**Korriku** – kur mbarojnë të mbjellat, bujku i kthen shpinën paramendës, me duar mbulon një pjesë të saj me dhë, që arrën të mos e dëmtojnë derrat e egër.

**Gusht** – në 12 ditët e para shikohet sesi do të jetë moti në 12 muajt e ardhshëm.

## STRUKTURA DHE KUPTIMI I KALENDARËVE PELLAZGË

Reformatori i parë i kalendarit roman ishte Numa Pompilio (dinastia Alba longa). Kalendarin e ashtuquajtur roman, rrjedhimisht erdhi nga etrusket, si popull pararomak në atë pjesë (etruskët formuan civilizimin romak, ndryshe etruskët njihen si pellazg dhe është verifikuar se gjuha e tyre mund të lexohet pa problem me shqipen e sotme, ashtu si çdo gjë tjetër që ka të bëjë me pellazgët,

<sup>1</sup> George von HANN, *Shënime për kalendarin e Rrëzës (Tepelenë), te Studime Shqiptare, 1854, botimi shqip, v.(2007*



shqipja shfrytëzohet si mjet deshifrimi.<sup>2</sup> Ajo që dihet është se Romakët nuk e sollën nga askund Kalendarin në Europë, por e morën direkt prej illirëve, kalendarin illirik, ashtu sikurse vetë latinët, pararomakët, që ishin vetë illirët, që nga hillirët e Hillionit, E Trojes – trojan, Etrurët (banorët e hershëm pararomak).

Kalendari javor e mujor ishte illirian, me 7 planetet e sistemit diellor - java, 7 ditët e Javës dhe 12 muajt e vitit, i cili fillonte nga muaji Mars. Vetë fjala - kalendar, është fjalë illirishte, ku fillohet me kalende, në shqip - ka le, është le, ka lindë, lindja e vitit të ri, ku viti kishte 10 muaj. Pellazgët e kanë njehësuar kohën në bazë të Diellit gjegjësisht, Hënës dhe kjo dokumentohet me numrin e djemve dhe vajzave të mbretit Pallas. Për nder të hyjnisë së Jupiterit, një perandor romak me origjinë illire, flijon në altar një kafshë. Ky veprim, i bën të dyshimtë shkencëtarët që të gjurmojnë në traditat yllire. Kjo e dhënë është e shkruar diku në librin e Aleksandër Stipçeviçit. Premteu (Prometeu), për pellazgët ishte hyjnia kryesore, pastaj te grekët roli i tij zëvendësohet me Zeusin. Edhe ky i fundit, zëvendësohet me Jupiterin te romakët. Kjo do të thotë se ndikimi i Premteut ishte më i madh dhe nuk zëvendësohej dot me të tjera hyjni.

### ***Kuptimi i kalendarëve grek***

Vlen të theksoj që ndryshe nga shqipja apo gjuhët e tjera anglo-gjermanike dhe variantet latine, greqishtja nuk i emërton ditët e javës sipas planeteve, por sipas radhës! Grekët nuk kishin kalendar, "calendas graecas" do të thotë kurrë, një shprehje ironike romake. Në Tegola është kalendari festiv që ngjitet në fakt në kohërat arkaike.

### ***Përfundim paraprak***

...prej Bunime, të paktën që nga kërthiza e bjeshkëve të Pindit deri në Jon e Adriatik, molosë, thesprotë e kaonë përdornin kalendarin e përbashkët pellazg (e jo helen), madje deri vonë, në shekullin II p.e.s.

### **KODE SHQIPTARE TE DITËT E JA(H)VËS**

Shtatë ditët e javës të gjuhës shqipe paraqesin një fushë, jo sa duhet të gjurmuar nga aspekti gjuhësor, por edhe fetar, historik e dokësor. Gjuha shqipe ka ruajtur emërtimin më autentik të mundshëm për ditët e Javës. Në shumë gjuhë të botës, kuptimi i ditëve të javës është reduktuar në kuptimin matematikor, numëror si "shtatëshi" apo "shtatëshja", madje edhe në hebraishten, e cila identifikohet me "besëlidhjen e Vjetër". Në Hebraisht, Java quhet Sheva, në kuptimin shtatëshi. Italisht, "Settimana", frëngjisht "Semaine", sllavisht "Sedmica", të gjitha këto në kuptimin, shtatë ditë, shtata apo shtatëshja. Vetëm gjuha shqipe ka ruajtur kodin e vjetër të kalendarit javor në trajtën krejtësisht autentike si "Ditët e Ja(h)vës" apo shkurtimisht "Java". Ky kod nuk mund të lidhet vetëm me "Dies jovis" të latinishtes, meqë emri Jov, më vonë Jovan, emër i gjinisë mashkullore, sipas fonetikës së gjuhës shqipe nuk mund të shqiptohet Java, që është emër i gjinisë femërore, ndërsa të

<sup>2</sup> Psh: <https://www.facebook.com/photo.php?fbid=168234583224319&l=0deac217ab>, që fillon me muajin velxitna/mars.

gjitha ditët e javës në gjuhën shqipe i përkasin gjinisë femërore. JAVA, është shkurtesa e koduar për mëvetësinë absolute të krijuesit.<sup>3</sup> Tetragrami hebraisht JHVH për ta patur një pasqyrë fillestare për JHVH mund të zërthehet vetëm me gjuhën shqipe dhe me asnjë gjuhë tjetër të botës, sepse kodi përmban esencën e besimit në një hyj, në kuptimin: Je Hy i Vetmi Hy.

**Formula e besimit hebraik përmbledhet në këto fjalë:** Ishmea Jishrail adonaj (JHVH) elohenu adonaj (JHVH) ehod. Në kuptimin shqip do të thotë: “Dëgjo popull i Izraelit, Zoti ynë (JHVH) është Një”.<sup>4</sup> Edhe në gjuhën arabe, formula e besimit islam përmbledhet me fjalinë e ngjashme për nga kuptimi, “Esh-shhedu en la ilahe il-lallah, Muhamedun resulu-llah” që do të thotë, “Dëshmoj se nuk ka tjetër (hy) veç Allahut dhe Muhamedi është i dërguari i tij”. Kodi i zërthyer në shqip:

J – Je                      H- Hy                      V- Vetmi                      H- Hy.

Në cilën gjuhë të botës do të gjendet një shpjegim i tillë fenomenal gjuhësor, përderisa një shpjegim i tillë i përkryer nuk gjendet në vetë gjuhën hebraike? Rastësinë me këtë rast e përjashton vetë fenomeni i Ditëve të Javës, gjashtë ditëve të krijimit të botës sipas Biblës dhe Kur’anit. Në traditën e hershme hebraike ka qenë e ndaluar të përmendet emri i plotë i Krijuesit. Katër shkronjat e koduara hebraike: Jod-Hi-Vav-Het, kanë qenë dhe kanë mbetur një kod specifik i besimit në një Krijues, në një Hy të Vetmin Hy, si krijues i përgjithshëm dhe i vetëm, i tokës, i gjallesave dhe i gjithësisë.

Studiuesi i religjioneve, Mexhid Yvjesi në një shkrim të tij në formë reagimi rreth studimit “Ditët e javës në gjuhën shqipe”, shkruar nga akademik Besim Bokshi, shkruan se Ditët e javës, së pari u përvetësuan në Romë në shekullin e IV, prej nga më vonë u përhapën në Evropë.<sup>5</sup> Me urdhër të perandorit romak, Konstantini i Madh, në vitin 321, u vendos që dita e parë e javës të caktohet dita e diel. Dita e diel u caktua si ditë e parë e javës për nder të Diellit, sepse prej kohësh, prej romakëve paganë, adhurohej kulti i Diellit, me emrin: Sol Invictus (Dielli i pathyeshëm, i pamposhtur). Dita e diel, ose dita e Diellit, dita e parë e krijimit Sipas librit të “Gjenezës” Hyji tha: “Le të bëhet dritë dhe u bë dritë”. Dhe Perëndia ditën filloi ta quante ditë, ndërsa errësirën e quajti natë.”<sup>6</sup> Në shumë gjuhë të botës, dita e diel, quhet dita e parë.

- Arab. “javmul ehad”, dita e parë,
- Hebraisht, “jom ehod”, dita e parë,
- Sllavisht, “nedelja”, vjen nga “njete delat”, (jo punë) dita e pushimit, është ngatërruar me kalendarin e krishterë. Në gjuhët sllave, Ditët e Jahvës kanë kuptim pagan, tokësor.
- Nedela, dita e papunë,
- Po-nedelnik, pas ditës së papunë,
- Utorak ose vtornik, e dyta ditë pasuese,

<sup>3</sup> <http://sq.wikipedia.org/wiki/JHVH>

<sup>4</sup> Enciklopedia e religjioneve të gjalla”, f. 705, Beograd, 1992, f. 705.

<sup>5</sup> Mexhid Yvjesi, Ditët e Javës në gjuhën shqipe. Jeta, si erdhi ajo këtu, botimi shqip i vitit 1995, interpretuar nga “Besëlidhja e Vjetër, Zanafilla”.

<sup>6</sup> Jeta, si erdhi ajo këtu, botimi shqip i vitit 1995, fq. 27, interpretuar nga “Besëlidhja e Vjetër, Zanafilla”.



- Sreda, dita e mesme,
- Cetvertak, dita e katërt,
- Petak, dita e pestë,
- Subota, dita e gjashtë.

Emrat e ditëve të javës në gjuhës sllave nuk kanë kuptim të mirëfilltë, përveç një ngjashmërie mbase edhe të rastit me fjalën hebraike Shabat- subota.

### ***E SHTUNË – SATURNI - IATUNI***

Emri “e shtunë”, rrjedh drejtpërdrejt nga emri Satun (Saturni), tek grekët Kronos. Sipas mitologjisë, Saturni ishte djali i Uranit dhe babai i Zeusit. Neve na intereson prejardhja ose etimologjia e këtij emri. Pra, ky emër e ka etimologjinë apo më mirë të them gjenezën tek emrat e parë që i njih historia, apo edhe te mitologjia. Mund të japim edhe një të dhënë tjetër. Se edhe te babilonasit e lashtë është i njohur ky emër. Babilonasit i kanë emëruar ditët në bazë të sistemit diellor. T’i kthehemi emrit të Saturnit. Edhe Satuni/Saturni është një planet në sistemin tonë diellor. Ilirët për nderim të kësaj hyjnie therrnin dema, mezer apo oqiçë. Festat e këtij planeti quheshin saturnale. Tek grekët nuk ka rëndësi të madhe kjo hyjni, sepse ishte kundërshtar i Zeusit. I biri e mposhti Satunin/Saturnin dhe ai ishte vetë Zeusi. Edhe hyjnia me emrin Pan ishte hyjni pellazge. Kishte brinjë cjapi, kishte thundra si të dhisë dhe ishte lemeritës, por kjo hyjni ishte simbol i pellazgëve. Ishte muzikant dhe fyelli i tij tregon identitetin e vërtetë. Edhe te disa persona që do të pasojnë, siç ishte mbrojtësi i kokave. Aleksandri i Madh p.sh, ishte adhurues i Panit.

Shtunak, i thuhet personit i cili kthehej vonë nga dita e tregut. Nga ky fakt mund të përfundojmë se dikur moti tregu është bërë vetëm ditën e shtunë, ditën e pushimit, dita e shtatë të javës, sipas kalendarit të moçëm dhe jo në ditën e diel. Përbetimi shqiptar për këtë ditë, doemos se kishte kuptimin e ditës së veçantë, meqë është e vetmja ditë në të cilën ata betoheshin.

### ***DIELL – DIELLI – DZEUZ - DZEWZ-ZWEZD***

Për këtë ditë të javës në gjuhën tonë figuron emri diell, e diel. Emri Diell paraqet yllin aktiv, qendrën e sistemit tonë planetar, paraqet qendrën e burimit të jetës. Të gjithë planetet sillen rreth Diellit. Këtij trupi qiellor, i gjithë njerëzimi i ka kushtuar falenderime për burimin e jetës, i ka bërë falenderime për burimin e dritës dhe të ngrohtësisë. Ndaj dhe i ngritën kulte e adhurime të ndryshme. E paraqesnin në figurime të ndryshme, në amulete, vazo, etj. Diellin e paraqesin si hyjni me emërtime dhe simbole të ndryshme. Emri i Diellit tek ilirët paraqitet si hyjni, në simbolikë si rreth, disk, apo edhe si kryq i lakuar. Kjo duket nëpër punime të ndryshme të qeramikës, në mburoja, në dekor armësh, në dekor femrash, etj. Këtu duhet përmendur Aleksandër Stipçeviçi, i cili bëri shumë gjurmime arkeologjike dhe studime mbi mitologjinë dhe simbolizmin ilir. Ndër të tjera, në veçanti u mundua që të shpjegojë se simboli i diellit në Iliri kishte rëndësi të madhe.

Svastika është një simbol që paraqet Diellin. Njëherësh, tregon kahjen e lëvizjes së tokës, kurse kuptimi i ndarjes së svastikës në katër pjesë, ka kuptimin e njehsimit të vitit apo të ndarjes së vitit

në stinë: Pranvera, Vera, Vjeshta dhe Dimri. Hynia e quajtur Helios paraqet Diellin te grekët. Është emër i diskutueshëm për nga origjina, sepse te pellazgët është shumë i afërt me këtë emër, sepse siç e dhanë përfundimin gjuhëtarë të ndryshëm, fjala dit' (ditë) është fjalë me burim pellazg, pra baza di është marrë nga emri Diell. Për etimologjinë e këtij emri të gjuhës shqipe, kanë shkruar shumë etimologë të huaj dhe shqiptarë, si E. Çabej, G. Mayeri, H. Pedersen, etj. Pra, kurrsesi etimolin e këtij emri nuk e zbërthejnë prej emrit të hyjnisë greke Helios, sepse emri ditë do të quhej *hitë*. Kësisoj i bie të jetë emërtim tipikisht pellazg. Edhe vetë gjuha e sotme greke nuk e emërton ditën e diel me këtë emër, por me emrin kiriaki, kurse te italianët emri i ditës së diel përmban kuptimin e ditës dominuese, pra, dita e parë në javë është dita e diel, me emrin domenica.

### **E HËNË - HËNA**

Edhe ky emër i gjuhës sonë, e hënë, është një emër i lashtë, pra, nga emrat e parë që njeh etimologjia. Si emër jep kuptimin e emërtimit të satelitit të tokës, p.sh: pjesë e shtuar e një objekti si aneks, pra edhe vetë ky trup qiellor është aneks i Tokës. Ky trup qiellor ka një vend të rëndësishëm tek Ilirët, por edhe më parë. Kemi rastin që këtë emër e identifikojmë me emrin Anzotika, në librin e Aleksandër Stipçeviçit, faqe 185. Ky emërim mundet të identifikohet me emrin “e hënë” dhe nuk do ta pëlqej se identiteti i këtij emri është Venera. Pra, ky trup qiellor kishte një rëndësi të madhe tek ilirët. Në bazë të pozicionimit të Hënës, ilirët numëronin kohën, muajt dhe deri diku edhe ndryshimet klimaterike. Këtë e them, sepse edhe në kohën e sotme, disa dinë të parashikojnë motin në bazë të ngjyrave apo skajeve të Hënës. Edhe pellazgët e njehsonin kohën apo vitin në bazë të Hënës.

- *Kjo traditë u përcoll edhe te mbreti i Trojës, Podarku dardan (Priami), i cili kishte 50 djem e 12 vajza.*
- *Këtu hasim numrin 12, i cili ishte shumë i rëndësishëm në mitologjinë e Ilirëve.*
- *Numri 12 tregon rrotullimet e Hënës rreth diellit, gjatë tërë vitit.*
- *Gjithashtu, numri 12 tregon një traditë të sotme shqiptare. Tek shqiptarët në log të burrërisë (pajtesave të ndryshme), secila anë duhet të ketë 12 burra (12+12 = 24), që do të thotë 24 pleq të pajtimit.*
- *Numri 12, përcakton nurin e fiseve të sotme më numerike që janë një lloj trashëgimie nga ilirët, çka edhe mund të identifikohet numri i fiseve me numër shumice ndër shqiptarë.*
- *Po edhe bajraçet e Mirditës, 12 ishin as më pak e as më shumë.*
- *Po me 12 degëza ishin edhe janë krahët e shqiptonjës.*

### **E MARTË – MARS - ARESI**

**Dita e martë, dita e tretë e krijimit** - Në vazhdim të punës së Krijuesit për të përmbuar gjithësinë, Ai, në ditën e tretë urdhëroi: “Le të mblidhen së bashku me një vend ujërat, që janë nën qiejt dhe le të shfaqet dhëu i thatë!” Dhe, ashtu u bë! Hyji filloi ta quante dhëun e thatë - tokë, ndërsa ujërat e bashkuar i quajti Det. Po në këtë ditë, Hyji urdhëroi krijimin e të gjitha bimëve, farërave dhe pemëve frutore.<sup>7</sup> Në gjuhën shqipe ekziston edhe emri popullor i gjinisë femërore, Martë-

<sup>7</sup> Po aty, Zanafilla.

a, sikundër edhe ai mashkullor si Martin. Nga ana tjetër, kjo ditë lidhet edhe me emrin e planetit Mars apo mund të lidhet me perëndinë pagane, të quajtur Mars. Mirëpo, shqipja i njeh të dyja trajtat, si Martë-a, po ashtu edhe Mars, muaji i tretë i vitit, sipas kalendarit. Fare lehtë akordon edhe krijimi i këtij planeti në ditën e tretë, duke filluar nga Dielli, Hëna, Marsi. Ky emër, e martë, me të cilin gjuha jonë emërton një nga ditët e javës, e ka etimolin në lashtësi. Emri i kësaj dite simbolizon njërin nga trupat qiellorë të sistemit tonë diellor, Marsin. Te grekët e vjetër kjo hyjni identifikohet me emrin Ares, te romakët Mars, te asirianët ishte emri i hynisë së luftës Marduk, te ilirët përdorej edhe Ares edhe Mars. Tani, kur shkenca e astrologjisë ka arritur të fotografojë me mjete të ndryshme këtë planet, mund të shkruajmë dhe të themi se vërtet planeti i Marsit ka ngjyrën e kuqe. Mund të vimë në përfundim sesi në periudhën qysh nga 2000 vjet p.e.s. e deri në kohën që lulëzoi perandoria romake, kjo hyjni personifikoi hyjninë e luftës. Ja pse edhe ngjyra e kuqe paraqet luftën, gjakun. Gjithashtu, ujku ishte një bishë përcjellëse e kësaj hyjnie. Kemi rastin e Remit dhe të Romulit, ku këta besohet se ishin bijtë e Rea Silvias me Marsin. Kurse simboli i ulkonjës paraqitet si mbrojtëse dhe kujdestare e tyre.

Hyjnia e Marsit (Aresi), në Luftën e Trojës, është e pranishme në shumë beteja. Në “Iliadë”, rrëfihen raste kur Marsi është inkuadruar drejtpërdrejt në luftë dhe anonte më shumë për ilirët. Kjo del në bazë të miteve, pasi populli ilir e më pas populli shqiptar kurrë nuk kanë qenë luftëdashës, por popuj mbrojtës. Hyjnia Mars ishte e interesuar që lufrat të vazhdonin medoemos, sepse ishte i etur për gjakderdhje, sepse ishte një hyjni e luftës. Për këtë ditë, edhe sot e kësaj dite në popullin tonë ekzistojnë thashetheme, bestytini dhe tradita për ditën e marte, si p.sh:

- të martën gratë nuk qepin,
- nuk punojnë në veg (mjet për punimin e qilimave),
- gjithashtu ka edhe besëtytni të tjera se dita e martë e ka një orë të ligë,
- ditën e martë nuk preferohet të bëhet pastrimi i krejt trupit.

Këto tradita apo besëtytni e kanë fillin tek hyjnia e luftës, Marsi.

### ***E MËRKURË - MËRKURI - HERMESI***

#### ***Dita e mërkurë, dita e katërt e krijimit***

Gjithnjë, duke urdhëruar zhvillimin dhe rregullimin e tokës dhe të gjithësisë, Hyji tha: Le të bëhen trupa ndriçues në shtrirjen e qiejve, që të bëjnë një ndarje midis ditës dhe natës, dhe ata duhet të shërbejnë si shenja edhe për stinët, edhe për ditët edhe për vitet. Dhe ata duhet të shërbejnë si trupa ndriçues në shtrirjen e qiejve për të shkëlqyer mbi tokë. Dhe ashtu u bë. Dhe Hyji vazhdoi të bënte dy trupat e mëdhenj ndriçues, si p.sh trupin më të madh ndriçues për të sunduar ditën, Diellin, dhe trupin më të vogël ndriçues, për të sunduar natën, Hënë, gjithashtu edhe yjet.<sup>8</sup> Në ditën e katërt të krijimit të tokës dhe gjithësisë janë dalluar, Dielli, Hëna dhe yjet.<sup>9</sup> Dita e katërt fare lehtë mund të

<sup>8</sup> Zanafilla, 1: 14 – 16. Psalmi 133: 7-9

<sup>9</sup> Po aty.

lidhet edhe me krijimin e planetit ndriçues, të quajtur Mërkur, ose Dita e Mërkurit, dita kur u rregulluan yjet ndriçues. Në gjuhën italiane, ditës së mërkurë i thuhet “Mercoledì”, në gjuhën hungareze “Szerda”, mbase nga sllavishtja, në gjuhën turke “Çarshamba”, në gjuhën frënge, “Mercredi”, në gjuhën angleze, “Wednesday”, e kështu me radhë.

Me këtë emër, e mërkurë, në gjuhën shqipe emërtohet një nga ditët e javës, sikur te disa gjuhë europiane. Njëherësh, ky emër i përket emrit të planetit Mërkur të sistemit tonë diellor. Te grekët e lashtë, ky emër paraqet një hyjni me emrin Hermes, i cili kishte rolin e postierit, lajmëtarit të Zeusit, që ishte dhe kryesori i hyjnive të Olimpikut sipas mitologjisë greke. Etruskët, këtë hyjni e emërtojnë me emrin Turnus, romakët me emrin Mërkur, kurse egjiptianët Harmachis-chepre-re-Atum. Duhet cekur se edhe disa popuj të tjerë që ishin nën sundimin romak, e emërtojnë këtë ditë njësoj, si edhe ditën e Hënë, e Martë, e Mërkurë dhe e Diel, si trashëgimi nga lashtësia, kur emëruan planetët. Edhe italishtja e ka trashëguar nga popuj më të hershëm. Ky emër mund ta ketë kështu origjinën nga dyndjet pellazgo-ilire, të cilat kanë përcjellë shumë fjalë të gjuhës së tyre te popuj të tjerë, siç është shembulli i Eneut dhe i disa perandorëve romakë me origjinë ilire.

#### ***E ENJTE – AETON – FETON - FEJTON (PHAETON) VENERA (AFËRDITA-APHRODITE)***

Ky emër në shqip emërton ditën e enjte të javës dhe nëse e njehsojmë, është dita e katërt e javës. Me këtë emër mund të simbolizohet edhe trupi qiellor i Venerës (Afërditës). Evolucioni i këtij emri prej Faeton në emrin e sotëm e enjte, është një kohë bukur e gjatë, diku rreth 3500 viteve, por ky emër haset tek ilirët. Në librin e Aleksandër Stipçeviçit, është paraqitur Fajtoni në anën e një fibule. Kurse te libri i Gustav Shvabit, fillon tregimi për këtë hyjni, nga faqja 40 deri në faqe 45. Faetoni (Fejtoni), ishte i biri i Feb-Apollonit.

*Përfytyrimi i kozmosit me planetët përkatës, qysh nga koha kur pellazgët studionin astronominë apo ligjet e gjithësisë që të spjegonin dukuritë, më sakt kataklizmot në tokë, si të ftohtin e madh, përmbytjen dhe hirin vullkanik.<sup>10</sup>*



Në bazë të mitologjisë, kur arriti në moshën madhore, shokët filluan ta përqeshnin, duke e injoruar se nuk ishte biri i Feb-Apollonit. Se po të ishte, duhet të shkonte e ta vizitonte të atin si mysafir në qiellin që i përket atij. Gjithashtu, për t’iu treguar shokëve se vërtet ndodhej tek i ati, le të

<sup>10</sup> Sazan GURI, *Misioni i shqipes dhe i shqiptarëve*, v. 2017 - *Të mos harrojmë se popujt e trungut pellazg (ilir, thrakë, etrusk) ishin shpikësit e ligjësisë astronomike, çka i dëftenin nëpërmjet ndërtimeve në tokë. Largësitë e piramidave janë, veçse distanca trupash qiellorë apo shkallët e tyre janë, veçse ligjësi të planetit tonë, etj.*



ngiste qerren e purpurtë të punuar prej ari dhe argjend nga Poseidoni, nëse dëshironte që të vërtetonte gjithashtu se vërtet ishte rritur.

### ***E PREMTJA***

Emri i ditës së Premte është filli i jetës, shkrimit, por edhe i gjeometrisë, dhe te gjithë numrave. Duhet parë fshehtësia! Pse niset dita e parë e javës prej të Premtes? Në vazhdim të perëndive pagane, njeriu adhuroi burimin e ujit (Bindusin – perëndi ilire), pasi ku kishte ujë kishte jetë. Jo më kot, luginat e lumenjve janë quajtur si vendlindje të qytetërimit. Më vonë do të shohim, pse njeriu i lashtë do të hyjnizojë bollëkun, që lidhej me konceptin e pjellorisë dhe të shumëzimit e të mbijetesës. Dhe ilirët si perëndi të pjellorisë e të shumëzimit, pra të bollëkut kishin atë që quhej “Prema”, që ne, shqiptarët e quajmë “E Premtja”.

I madhi Konica i mbështetur në studimet e një studiuesi gjerman, dr. M. Flus jep mendimin se Ilirët kishin hyjnitë e tyre para se të pushtoheshin nga Romakët. Dhe më tej vazhdon se meqenëse nuk pati fërkime për shkaqe fetare ndërmjet fituesve pushtues romak dhe humbësve ilir, del në konkluzionin se hyjnitë vendase ilire, ndonëse me emra të tjerë u përkonin perëndive romake. Pas pushtimit, romakët ngrinin altare për hyjnitë, pavarësisht nga emri i vjetër apo i ri. Kështu për “Të Premten” Faiku shprehet: “Prema ka qenë hyjnesha e pjellorisë dhe e shumëzimit. Ajo e ka lënë emrin e saj tek e premtja, që është emri shqip i kësaj dite të javës, dhe u përgjigjet Venusit të Romakëve dhe Frejes së Teutonëve”.

### ***Dita e shtunë, dita e shtatë, dita e pushimit***

Përderisa në gjashtë ditët e para, Hyji JAHV krijoi tokën dhe gjithësinë, ditën e shtunë, e shpalli ditë të pushimit. Kjo ditë, në traditën hebraike konsiderohet si ditë e shenjtë, dita e pushimit të mirëfilltë dhe të domosdoshëm. “Të shtatën ditë hyji e kreu punën e vet që kishte bërë. Të shtatën ditë pushoi nga çdo punë që kishte bërë. Hyji e bekoi të shtatën ditë dhe e shenjtëroi, sepse atë ditë kishte pushuar prej çdo pune, që Hyji kishte bërë duke krijuar.”<sup>11</sup> “Zoti e bekoi ditën e shtatë. Që atëherë, Ai vendosi që të gjithë njerëzit duhet të pushojnë në “shabat”, të shtunën. Kjo ditë duhej të ishte dita e Perëndisë”.<sup>12</sup> Tradita e krishterë, madje edhe vetë Jezusi kishte thyer shenjtërinë e kësaj dite. Për këtë ai kishte acaruar edhe më tej moskuptimet me interpretuesit dhe Besëlidhjes së Vjetër. Dhe pikërisht për këtë kalendari i krishterë ndërroi edhe radhën e këtyre ditëve, duke marrë pikënisje ditën e hënë si ditë të parë të krijimit, ndërsa si ditë pushimi, ditën e diel. Besimi hebraik, domosdoshmërinë e shenjtërimit të kësaj dite e ka kthyer në kult. Fjala “e shtunë” në gjuhën shqipe është cilësuar me etimologji të errët nga Eqrem Çabej. Në fjalorin e gjuhës shqipe, faqe 1943, thuhet e shtuna është dita e gjashtë e javës. Nuk është bërë asnjë përpjekje për ta zbërthyer etimologjinë e kësaj fjale, madje nuk janë shpjeguar as derivatet e saj, si shtunak, shtunor, etj.

<sup>11</sup> Don Simon Filipaj, *Bibla, Shkrimi Shenjt*, f. 20, Ferizaj 1994, f. 20

<sup>12</sup> ( Anne de Vries, *Libër i Madh me tregime për Historinë e Biblës*, Stichting Antwoord, fq. 3, v. 1992.

### ***PËRFUNDIME PARAPRAKE***

Kuptimi i disa prej ditëve të javës ka lidhje të plotë me gjuhën shqipe, duke na simbolizuar perënditë e para pagane të njeriut parak, siç ishin pellazgët. Dhe këtë lidhje na e dëftën shpjegimi i mëposhtëm:

- E enjte, marrë nga perëndia ilire e Zjarrit Enji dhe Anji;
- E premte, marrë nga perëndia ilire Preme;
- E shtunë, marrë nga perëndia ilire Shtuni;
- E dielë, marrë nga perëndia ilire pellazge Dielli.

Jo rastësisht, Ikona e Shën Premtes vishet në të zeza, që më vonë simbolizohet po e tillë, si “E Premte e Zezë” e Jezu Krishtit.



“RRËNJËT TONA”